



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA IV

Sesioni vjeshtor

Komisioni për Bujqësi, Pylltari, zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor

Mbledhja nr. **98**

Prishtinë, më 17.12.2012, ora 11,00

Ndërtesa e Kuvendit, sala N-302

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT

Në mbledhje morën pjesë: Nait Hasani, Rasim Demiri, Sevdije Lama, Afërdita Berisha-Shaqiri, Salih Morina, Daut Haradinaj dhe Boban Todorović.

Munguan : Nijazi Idrizi, Liburn Aliu.

Të ftuar dhe pjesëmarrës tjerë: sipas listës së nënshkruar nga pjesëmarrësit.

Stafi mbështetës i komisionit: Bajram Badivuku dhe Ylber Sherifi.

Mbledhjen e kryesoi **Nait Hasani**, kryetar i komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky rend dite :

1. Miratimi i rendit të ditës,
2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së komisionit, të mbajtur më 11.12.2012,
3. Shqyrtimi i Projektligjit për shfrytëzimin dhe administrimin e ndërtesave në bashkëpronësi,
4. Të ndryshme.

Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 11.12.2012

Kryetari i Komisionit konstatoi se Komisioni miratoi Procesverbalin e mbledhjes së mbajtur më 11.12.2012 duke riformuluar vendimin e Komisionit rreth aprovimit të nismës për hartimin e Projektligjit në fjalë, ndërkaq Kryetari kërkoi nga stafi mundësisht mos të shkruhen me nguti disa vendime të Komisionit, përkundër faktit se ato mund të përmirësohen deri në miratimin e procesverbalit.

3. Shqyrtimi i Projektligjit për shfrytëzimin, administrimin dhe mirëmbajtjen e ndërtesave në bashkëpronësi

Kryetari i Komisionit falënderoi zyrtarët e projektit dhe z. Donovan rreth vërejtjeve të hartuara për mbledhjen e sotme për këtë Projektligj dhe ju dha fjalën për arsyetimin e tyre.

Valentina Haziri duke u nisur nga sugjerimi për ndryshimin e titullit, në vazhdim sqaroi vërejtjet të cilat bashkërisht me komisionin u komentuan deri te Neni 20. Në shumicën e Neneve u arrit pajtimi me Komisionin, ndaj për mbledhjen e radhës u propozua të vazhdoi puna aty ku ka mbetur.

4. Të ndryshme

Kryetari i Komisionit njoftoi për dy ftesa që kanë arritur në Komision për ditën e nesërme, në Gjakovë ku do të shpallet fermeri i vitit, dhe në Prishtinë në takim përmbysllës të Agjencisë Mjedisore rreth aktiviteteve mjedisore, ndaj i luti anëtarët e Komisionit të cilët shprehin dëshirën me marr pjesë, të koordinohen me stafin mbështetës.

Mbledhja përfundoi në orën 12,30.

Përgatitur nga:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit,
Nait Hasani